

AKT THEMELUES

I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE

"ROXHER KONSTRUKSION" SH.P.K.

Unë Fatos Rustem, i biri i Bexhetit I, dtl 11.11.1964, lindur në Korçë dhe banues në Njësia bashkiake nr 6, Rr. Haki Stermilli, ndërtesa private nr 46, Tiranë, mbështetur në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" dhe në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", sot më datë 01.09.2023, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ROXHER KONSTRUKSION", me aktin themelues të saj si vijon :

FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqëria private e quajtur "ROXHER KONSTRUKSION" sh.p.k. Shoqëria do ti nënshtroht legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqërisë tregtare private "ROXHER KONSTRUKSION" sh.p.k. do të jetë : Njësia bashkiake nr 6, Rr. Haki Stermilli, Ndërtesa private nr 46, Kati i Pare, Tiranë, Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organve kompetente edhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakut themelues të saj.



OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e:

1. Ndertime civile dhe industriale, Punime armature, Punime hekuri, Punime shtresa, Punime murature, rifiniture, hidraulike , elektrike etj.
2. Tregtimin me shumicë e pakicë dhe import-eksport të:
 - Mallra industriale, ushqimore, lëndë të para, pjesë këmbimi për makina, hidro – sanitare, hidraulike, kanceleri për zyra e shkolla, orendi shtëpiake, mobilje te ndryshme, pajisje elektrike e elektronike, kinkaleri, elektro – shtëpiake, kompiuterike.

NENI 4

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të sigurojë mjetet e nevojshme dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE


NENI 5

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare private “**ROXHER KONSTRUKSION**” sh.p.k. do të jetë **100.000** (njeqind mijë) lekë dhe do të përbëhet nga kuota e ortakut themelues të shoqërisë. Kapitali përbëhet nga 1 kuota dhe vlera nominale e një kuote është e barabartë me **100 000** lekë. Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet sipas vendimit të ortakut themelues. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.



NENI 7

Ortaku i vetëm duhet të bëjë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajë sekretin e saj dhe të mos dëmtojë interesat e personave të tjerë dhe të shoqërisë.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Z. Fatos Rustem, i cili është përfaqësues ligjore i saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhë kohore prej 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut themelues të shoqërisë.

NENI 10

Ortaku themelues ka të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale të shoqërisë. Ai ka të drejtë të caktojë financiar, likuidator për problemet e shoqërisë, si edhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

NENI 11

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykohen dhe zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme, me tekstin për rrethin e saj.

NENI 13



Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”.

NENI 14

Ky akt themelimi përpilohet në tre kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, njëra në zyrën e Tatimeve dhe kopja e tretë mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare
“**ROXHER KONSTRUKSION**” sh.p.k.

Akti i themelimit nenshkruset rregullisht nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

“**ROXHER KONSTRUKSION**” sh.p.k

Fatos Rustem

